





*Konsulencë  
ligjore*

*Ekspertizë për çështjet e  
shëndetit dhe sigurisë në  
punë*

*Shërbime ndërmjetësimi  
në punësim*

*Këshillim në përzgjedhjen e  
institucioneve të përshtatshme  
mjekësore*

## Hyrje

SiCRED Assistance është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe kapital privat, (zotërohet ne masën 100% nga shoqëria SiCRED sh.a.) që ofron konsulencë ligjore, këshillim në menaxhimin e çështjeve të legjislacionit të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, shërbime ndërmjetësimi në punësim dhe ndërmjetësim në shërbime mjekësore brenda dhe jashtë vendit.

Duke ndihmuar klientët tanë për të kuptuar, menaxhuar dhe zvogëluar rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në punë, ne ofrojmë një zgjidhje me kosto efektive.

Duke dhënë këshilla dhe mbështetje nëpërmjet një ekipi konsulentësh të kualifikuar dhe profesionistësh në çështjet e legjislacionit të punës dhe çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, ne ofrojmë këshillim për një mjedis pune më të sigurt.

Duke përdorur shërbimet e ofruara nga SiCRED Assistance sh.p.k., ju ulni kostot dhe ekspozimet tuaja të përgjithshme ndaj rreziqut të sigurisë dhe shëndetit në punë, e kështu mbërrini në standardin e pajtueshëm me legjislacionin në fuqi.

Duke marrë shërbimet profesionale në ndërmjetësim dhe përfundimin me sukses të marrëveshjeve për veprimtari të çdo lloji natyre qofshin ato, nga SiCRED Assistance, ju si klient përkundëjt shpërblimit, do të keni garancitë ligjore, se çfarë është përcaktuar në kontratë si shfaqje e ligjshme e me vullnet të lirë, do të realizohet me sukses nga shoqëria.

Duke përdorur shërbimet e ndërmjetësimit që ofron shoqëria, ju si klientë do të mund të shfrytëzoni oportunitetin të zgjidhni në rrjetin e institucioneve mjekësore brenda dhe jashtë Shqipërisë, shërbimin mjekësor cilësor të këshilluar.

Duke përdorur shërbimet e SiCRED Assistance për ndërmjetësimin në punësim, do të merrni një shërbim profesional ku zbatohen politikat aktive të përgjithshme të shtetit dhe mbështetet punësimi i plotë, produktiv dhe i zgjedhur lirisht, i të gjithë shtetasve e rezidentëve në Shqipëri, pavarësisht shtetësisë për punësim fitimprurës, për kualifikimin profesional për çdo punësim.

Përpjekjet për të negociuar dhe për të realizuar me sukses ndërmjetësimin dhe brenda qëllimeve të ligjshme të shfaqura me vullnet të lirë në kontrate, besojmë se i shtojnë vlerat jashtëzakonisht si klientëve tanë, por edhe emrit të mire të shoqërisë.

Ky mentalitet sipërmarrës është pjesë e objektivave të shoqërisë, si dhe anëtarëve të ekipit, që i janë bashkuar në këtë sipërmarrje që nga themelimi i saj viti 2012.



## Vizioni

Të krijojmë një kulturë dhe mjedis për të pasur punonjës të shëndetshëm në shoqërinë tonë sot dhe në brezat që vijnë. Me shërbimin tonë synojmë të përmbushim sfidat e klientëve tanë me qëllim pajtimin e kushteve më të mira të punës për punëmarrësit, trajtimin me kujdes të marrëdhënieve të punës dhe në mënyrë të posaçme edhe çështjet e kujdesit shëndetësor. Nën moton për të hequr kufijtë e të hapim perspektiva të reja në marrëdhëniet e punës, ne jemi të përkushtuar për të adresuar rreziqet e kësaj industrie, duke zhvilluar dhe edukuar shoqërinë me praktika të qëndrueshme, të domosdoshme dhe efikase të përdorura gjerësisht ndërkombëtarisht.

## Misioni

SiCRED Assistance sh.p.k., nëpërmjet konsulencës që ofron, tenton të ndikojë në përmirësimin e shëndetit të publikut, duke këshilluar masa mbrojtëse nën frymën e legjislacionit në fuqi për të gjitha entitetet punëdhënëse. Si aktorë të këtij tregu, ne propagandojmë për t'u forcuar dhe mbështetur nga e gjithë shoqëria shëndeti publik. Ne flasin për çështjet e shëndetit publik duke u mbështetur në politikat ligjore të punës, gjithaq edhe nga shkenca që zhvillon këtë fushë. Ne jemi shoqëri me kapital privat e duam të ndikojmë në politikën e punëdhënësve për të respektuar standardet e punës, por në të njëjtën kohë duam edhe të sensibilizojmë dhe edukojmë shoqërinë tonë që në mjediset shkollore, që së bashku të arrijmë të krijojmë kombin më të shëndetshëm.

## Sfidat

Identifikimi i zgjidhjeve, rishqyrtimi e rivlerësimi i metodave, kërkimi i alternativave, janë të gjitha sfidat që na dretojnë çdo ditë në aktivitetin tonë të përditshëm, në përpjekje për të përballuar këto sfida, duke mbështetur zbatimin e legjislacionit të punës në çdo kategori punësimi e duke mbështetur sistemin e kujdesit shëndetësor koheziv, e të arritshëm për të gjithë.

## Projektet

SiCRED Assistance sh.p.k. u krijua me qëllim të përgjigjes ndaj nevojës ligjore për standarde më të mira pune në vijimësi në rritje për ndërtimin e një bashkëveprimi mirëkuptues ndërmjet aktorëve që zbatojnë legjislacionin e punës, legjislacionin e shëndetësisë dhe autoriteteve publike me influence në kontroll, monitorim, përshtatje standardesh. Pas 6 viteve në këtë industri, angazhimi ynë përforcohet dhe merr edhe trajta dhe dimensione të tjera. Sot ne ofrojmë udhëzime për kompanitë vendore, organizatat profesionale dhe shoqatat, lidhur me punën e tyre të përditshme, projektet e tyre, pozicionimin e tyre dhe investimin e tyre në favor të kushteve më të mira të punës, mjediseve të punës, kontratave të punës, pa dallim racor, gjinor, moshor, kufizimi fizik, përkatësie etnike, apo fetare.

## Identitet

Ndërsa shumica e klientëve tanë veprojnë në nivel kombëtar, çështjet që ne trajtojmë me shërbimin tonë nuk kanë natyrë vetëm kombëtare, por edhe globale e ambicia jonë më e madhe është të veprojmë në përmbushje të nevojave të subjektit punëdhënës, duke menduar për një qasje globale në çështjet e punës, punësimit dhe shëndetit.

**Besimplotë se e ardhmja do të jetë më e mirë me punën në grup.**

Sinqerisht,

Vjosa BODO MUJO  
Administrator  
i SiCRED Assistance sh.p.k.

*Vjosa Bodo Mujo*  
10.05.2019



## Shërbimet e Shëndetit dhe Sigurisë në punë

Në SiCRED Assistance sh.p.k., konsulentët tanë të Shëndetit dhe Sigurisë janë profesionistë të kualifikuar me një përvojë të gjerë në fushën e zbatimit të legjislacionit në tërësi dhe atij specifik të punës.

*Paketa e shërbimeve në dispozicion për klientin përfshin si në vijim:*

### ► **Kompetencë profesionale**

SiCRED Assistance sh.p.k. përmbush rolin e saj këshillues me kompetencë dhe profesionalizëm sipas standardeve të vendosura nga legjislacioni në fuqi për çështjet e Sigurisë e Shëndetit në Punë. Avantazhi ynë është cilësia e punonjësve tanë dhe aftësia për të punuar në një ekip multi-disiplinar me përkushtim dhe përvojë profesionale. Ne ju ofrojmë njohuritë e fituara nga përvoja dhe idetë dhe shërbimet që ne ju ofrojmë, ju ndihmojnë të përmbushni kërkesat tuaja në pajtueshmëri me praktikën ligjore të gjithë-pranuar.

### ► **Auditim për çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në punë**

Auditim të praktikave tuaja të punës dhe rekomandime sipas rastit për të zbatuar standardin ligjor të zbatueshëm për Shëndetin dhe Sigurinë në punë.

### ► **Dokumentim të politikave të rrezikut në punë**

Raporte me shkrim për politikat e rrezikut në mjediset e punës, si dhe rekomandime për ndërtimin e praktikave të sigurta të punës e vlerësimet e nevojshme të rrezikut.

### ► **Trajnime**

Shoqëria ofron trajnime praktike për Dhënien e Ndihmës së Parë.

### ► **Këshilla dhe përditësime**

Shoqëria do të këshillojë në vijimësi subjektin tuaj lidhur me ndryshimet në legjislacionin e punës dhe për aq sa ai implikon procedurat e punës në aktivitetin tuaj.

### ► **Hetimet e Aksidenteve**

Shoqëria ndihmon në analizimin, raportimin dhe menaxhimin e aksidenteve ose incidenteve të rënda të ndodhura në aktivitetin e mjediset tuaja të punës.

### ► **Tarifa për shërbimin e konsulencës së SiCRED Assistance**

SiCRED Assistance mund të ofrojë shërbimin e këshillimit bazuar mbi tarifa orare + TVSH për çdo kohë të shpenzuar për hetimin e aktivitetit të ndodhura në mjediset e punës dhe ose për shkak të punës sipas legjislacionit të punës në Republikën e Shqipërisë për Shëndetin dhe Sigurinë.



## ***Mbështetje në zbatimin e legjislacionit të Punës***

SiCRED Assistance ofron shërbime këshillimi për zbatimin e legjislacionit të punës në fuqi, nëpërmjet një ekipi të përkushtuar profesionistësh të kualifikuar dhe me përvojë. Ju do të keni nga avokatët e shoqërisë mbështetje dhe këshilla të qarta ligjore. Këto shërbime në dispozicion për ju përfshijnë si në vijim:

### ***▶ Këshillim për Procedurat e Punësimit***

Auditim, vlerësim e rekomandime me karakter këshillues ndaj procedurave tuaja të punësimit me synim zbatimin e standardit ligjor dhe praktikat më të mira të legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

### ***▶ Këshillim për Kontratat e Punësimit***

Hartim dhe përgatitje të kontratave të punës për aktivitetin tuaj. Ne gjithashtu ofrojmë shërbimin e rishikimit dhe përditësimit për çdo kontratë pune që tashmë subjekti juaj ka në zbatim dhe në fuqi.

### ***▶ Këshilla dhe konsultime***

Këshillim e konsultime të pakufizuara në të gjitha aspektet e ligjit të punës, përfshirë riorganizimin e ndërmarrjes, pagat sipas niveleve, marrjen e masave disiplinore, zbatimin e lejeve, orëve të punës, kohës shtesë, pagesat për paaftësi dhe leje sipas legjislacionit në fuqi.

### ***▶ Përditësime***

Aty ku do të jetë e përshtatshme, shoqëria do prezantojë me shkrim çdo përditësim që pëson legjislacioni i punës në Republikën e Shqipërisë si dhe ndikimet që kjo qasje mund të përcjellë në aktivitetin e biznesit tuaj.

### ***▶ Përgjigje me shkrim***

Shoqëria do të përgatisë përgjigje me shkrim sipas kërkesës suaj për çdo korrespondencë tuajën me palë të treta, që ju si subjekt mund të merrni nga punonjësit e pakënaqur ose ish-punonjësit tuaj.

### ***▶ Seminare***

SiCRED Assistance organizon periodikisht seminare për 'tema specifike' brenda fushës së legjislacionit të punës, në të cilat ju jeni të ftuar lirisht të merrni pjesë.

### ***▶ Trajnime***

SiCRED Assistance ofron mundësinë e këshillimit të menaxhereve të burimeve njerëzore të entitetit tuaj me procedura të mirë shkruara.



## ***Udhëzues për Punonjësit***

SiCRED Assistance ofron mundësinë e përgatitjes së plotë të udhëzuesve për punonjësit tuaj në përcaktimin e standardeve dhe rregullave etike, disiplinore, kundër mashtrimit apo risqeve ndaj të cilave mund të ekspozohet aktiviteti juaj e sipas të cilëve pritet që punonjësit tuaj t'u pëmbahen e zbatojnë.

### ***Mbrojtje e Përfaqësimit***

SiCRED Assistance mund të ofrojë mbrojtje të interesave tuaja para gjykatës apo organeve të tjera shtetërore lidhur me çdo mosmarrëveshje, përfshirë edhe mosmarrëveshjet e punësimit dhe çdo rrjedhojë që vjen prej tyre, duke siguruar shërbim në vijimësi nga korrespondenca fillestare e gjatë gjithë procedurës së ndjekur për rastin, sipas kërkesës.

### ***Trajnim për çështje të shëndetit dhe sigurisë***

SiCRED Assistance mund të ofrojë trajnim për çështjet e shëndetit dhe sigurisë. Kjo është një mënyrë e përkryer për t'ju ndihmuar të angazhoni punonjësit tuaj në ndërgjegjësimin e çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke siguruar gjithashtu një mbrojtje më të mirë të biznesit tuaj nga kërcënimi i përgjegjësiave civile.

Në SiCRED Assistance konsulentët tanë kanë aftësi dhe kompetence për të ofruar kualifikime e trajnime brenda vendit të ndërtuara posaçërisht për biznesin tuaj.

Disa nga trajnimet që ofrojmë përfshijnë:

- a - Dhënie e Ndihmës së Parë në Punë
- b - Trajnim për Çështjet e Sigurisë e Shëndetit në Punë

Në SiCRED Assistance konsulentët tanë kanë aftësi dhe kompetence për të ofruar raporte këshilluese të analizës së riskut në mjediset e punës të ndërtuara mbi të dhënat specifike të biznesit tuaj.

Disa nga raportet që ofrojmë me shkrim dhe që përfshijnë detaje mbi mënyrën se si duhet të reduktohet rreziku janë:

- a - raporti i analizës së riskut të mjedisave në vendin e punës
- b - raporti i analizës së riskut të çdo pozicioni pune



## Shërbimet e Ndërmjetësimit në Punësim

SI-CRED Assistance sh.p.k. ofron shërbime në ndërmjetësim në tregun e punës, si agjenci punësimi private mbështetur në licencën specifike që ka marrë për këtë shërbim pranë autoriteteve shtetërore shqiptare, nëpërmjet një ekipi të përkushtuar profesionistësh të kualifikuar dhe me përvojë. Ju do të keni nga avokatët e shoqërisë mbështetje dhe këshilla të qarta ligjore. Këto shërbime në dispozicion për ju përfshijnë si në vijim:

### ▶ **Këshillim për Procedurat e Punësimit**

Këshillim ndaj çdo personi që kërkon punë rishtazi (punësim për herë të parë) ose punë të re, apo këshillim ndaj çdo subjekti publik apo privat që kërkon të punësojë punonjës të kualifikuar shqiptarë apo të huaj, apo punonjës sezonalë sipas standardit ligjor dhe praktikave më të mira të legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

### ▶ **Këshilla dhe konsultime**

Këshillim e konsultime të pakufizuara në të gjitha aspektet e ligjit të punës, ligjit për të huajt, përfshirë edhe procedurat për punësimin e të huajve me kontratë afatgjatë, afatshkurtër apo dhe sezonale në Republikën e Shqipërisë.

### ▶ **Këshillim për Kontratat e Punësimit**

Hartim dhe përgatitje të kontratave të punës përshtatur sipas aktivitetit tuaj edhe për punonjës të huaj sezonalë apo me kontratë punësimi afatgjatë. Ne gjithashtu ofrojmë shërbimin e rishikimit dhe përditësimit për çdo kontratë pune që tashtë subjekti juaj ka në zbatim dhe në fuqi.

### ▶ **Procedura për ndërmjetimin në punësim të të huajve**

Shoqëria do të përgatisë dhe transmetojë çdo kërkesë apo dokument, sipas porosisë suaj, për çdo punonjës të huaj që ju doni të merrni si të punësuar në aktivitetin tuaj, përfshirë edhe çdo korrespondencë tuajën me palë të treta, si shoqëri të huaja ndërmjetësimi, zyra konsullore për marrje vizash, zyra shtetërore pranë të cilave aplikohet dhe merren lejet e qëndrimit, lejet e punësimit, apo procedura të tjera që ju si subjekt mund të keni në vijimësi domosdoshmërinë të plotësoni për punonjësit tuaj të huaj.

### ▶ **Bashkëpunimi me Partnerë Ndërkombëtarë**

SI-CRED Assistance sh.p.k. ka mundur bashkëpunimin kontraktuar me subjekte të huaja (përmendim këtu tek partnerët e huaj Century High HR INC. Rm. 201-202 Merchant Bldg., 509 Padre Faura St., Ermita, Manila; Filipine) për të ofruar shërbime të ndërmjetësimit në punësim specifikisht për:

- a) ndërmjetësime për punësim të punonjësve me kualifikim të veçantë.
- b) këshillim dhe orientim për punë dhe profesion në tregun shqiptar.

### ▶ **Partneriteti**

Duke pasur nën vëmendje që suksesi i klientëve tanë do të thotë gjithçka për ne, ne përkujdesemi me gjithë energjinë tonë në realizimin e këtij qëllimi. Kjo kërkon profesionalizëm absolut, besnikëri dhe mendje-largpamësi. Prandaj, ne krijojmë një atmosferë dhe frymë besimi të ndërsjellë dhe dialog konstruktiv, me klientët punëkërkuar për ndërmjetësim. Ne i shohim klientët dhe konsulentët tanë si një ekip të përbashkët. Kjo është arsyeja pse partneriteti është një nga vlerat tona kryesore. Nëse do të punojmë së bashku, ne do të përpiqemi të japim rezultate, duke gjetur mënyra për të optimizuar shfrytëzimin e kapaciteteve tuaja profesionale në tregun e punës.





## **Shërbimet e Ndërmjetësimit në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor**

SiCRED Assistance sh.p.k. ofron shërbime ndërmjetësimi në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor; si agjenci private mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe në përvojën specifike të një ekipi të përkushtuar profesionistësh. Ju do të keni këshillim dhe sugjerimin nga shoqëria në dilemën tuaj për të përzgjedhur institucionin e përshtatshëm mjekësor. Këto shërbime në dispozicion për ju përfshijnë si në vijim:



### **► Këshillim për përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor**

Konsulentët tanë do t'ju udhëheqin për të analizuar anët tuaja të forta, dobësitë, mundësitë dhe kufizimet tuaja në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor; në këtë mënyrë ju do të identifikoni kufizimet dhe mundësitë tuaja. Nëse do të punojmë së bashku, ne do t'ju bëjmë më të fortë për të përballuar problemet me shëndetin tuaj brenda kapaciteteve dhe mundësive tuaja.

### **► Procedura për ndërmjetimin në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor**

Shoqëria do të përgatisë dhe transmetojë çdo kërkesë apo dokument, sipas porosisë suaj për çdo institucion mjekësor pranë të cilit ju do të vendosni të kryeni shërbime mjekësore, përfshirë edhe çdo korrespondencë tuajën me palë të treta, sipas përcaktimeve të kontratës.

### **► Eficencë maksimale**

Ne ofrojmë shërbimet ndihmëse për përzgjedhje të institucionit të përshtatshëm mjekësor; varësisht nga specifikat e rastit mjekësor; por edhe kufizimeve ekonomike. Ne ofrojmë shërbimet ndihmëse në përzgjedhjen e kostos më adekuate në kushte të pazakonta, duke përfshirë dhe mos anashkaluar çështjet e mjeteve të transportit për pacientin dhe familjarët shoqëruar, çështjet e akomodimit, rezervimit dhe hotelerisë në spital apo mjedise të tjera pritjeje për pacientin dhe bashkë familjarët shoqëruar, si dhe çështjet e ndjekjes dhe konsultave në vijimësi nëse rasti e kërkon.

### **► Ne jemi të fokusuar dhe të saktë**

Ne kuptojmë që sfidat tuaja në tregjet konkurruese të industrisë së shëndetësisë ndryshojnë me shpejtësi. Konsulentët tanë sjellin vlerë për përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm për kurimin tuaj me përvojën, të cilën e kemi fituar me eksperiencë. Zgjidhjet e ofruara nga ne për përzgjedhjen e institucionit mjekësor të përshtatshëm janë tërësisht të bazuara mbi, lirinë tuaj për të përzgjedhur dhe pranuar këshillimin e ligjshëm. Ne përpiqemi të japim rezultate, duke gjetur mënyra për të optimizuar shfrytëzimin e kapaciteteve tuaja, në rrethanat të pazakonta.

### **► Bashkëpunimi me Partnerë Ndërkombëtarë**

SiCRED Assistance sh.p.k. ka mundur bashkëpunimin kontraktuar me subjekte të huaja, përmendim këtu Humanitas Mirasole spa, Milano, Itali; Istituto Auxologico Italiano, Milano, Itali; Acibadem, Turqi, LIV Hospital, Turqi, për të ofruar shërbime të ndërmjetësimit në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor.

## Ekspertët tanë

Ne vendosim përvojën tonë më të mirë në punën që bëjmë për ju. Qasja jonë përcjell drejt urgjencat si dhe objektivitetin në zhvillimin dhe ekzekutimin e strategjive të reja. Procesi ynë i disiplinuar përfshin vlerësimin dhe identifikimin e shpejtë të sfidave të tregut të punës, si dhe zhvillimin e një plani veprimi që do të rrisë vlerën e ndërmarrjeve të vogla, të mesme apo të mëdha qofshin ato. Ekipi ynë është një trofe udhërrëfyes.




**VJOSA BODO MUJO** - lindur 1979, Administrator nga themelimi i shoqërisë SiCRED Assistance sh.p.k.; Tiranë, Shqipëri.

Vjosa Bodo Mujo është Diplomuar në Universitetin Publik të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në vitin 2001, ku ka fituar titullin "Jurist". Ajo në vitin 2002 ka kaluar suksesshëm provimin e avokatisë e që prej 2002 rezulton anëtare e dhomës së Avokatisë së Tiranës. Nën cilësinë e avokatit ka praktikuar për më shumë se një dekadë krahas këshillimit ligjor edhe mbrojtjen gjyqësore në të tre shkallët e gjyqësorit çështje të ligjit të punës, ligjit mbi pronën, ligjit tregtar, ligjit mbi sigurimet, ligjit mbi detyrimet bankare, detyrimet kontraktuale dhe jo kontraktuale, ligjit tatimor, ligjit administrativ, ligjit familjar, ligjit penal, legjislacionit mbi mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtën private, ligjit mbi shërbimin civil. Vjosa Bodo Mujo përfundoi studimet e thelluara pasuniversitare në Universitetin publik të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Katedra e të Drejtës Publike, duke marrë në vitin 2011 titullin M.P.A./Master në të Drejtën Publike dhe Administrim Publik.

Pas eksperiencës 7-vjeçare të fituar pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Tiranë, veçanërisht në ligje dhe në marrëveshje, Vjosa Bodo Mujo në vitin 2009 u bë pjesë e ekipit të juristëve të shoqërisë së sigurimit të jetës SiCRED sh.a., ku vijoi të praktikojë e zbatojë dijet në fushën e ligjit tregtar dhe legjislacionit civil seksioni "Sigurimet". Në vitin 2011 Vjosa Bodo Mujo emërohet Drejtor Juridik dhe i Burimeve Njerëzore pranë shoqërisë SiCRED sh.a., dhe në të njëjtin vit ajo emërohet edhe Kryetar i Bordit të administrimit të shoqërisë së fondeve të investimit dhe pensioneve Credins Invest, funksione të cilat respektivisht i kryen edhe aktualisht.


Vjosa Bodo Mujo drejton si administrator i vetëm që prej vitit 2012 dhe aktualisht shoqërinë konsulente SiCRED Assistance sh.p.k., duke konsultuar punëdhënësit shqiptarë e të huaj mbi domosdoshmërinë e zbatimit të metodologjive të legjislacionit specifik të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe shërbimeve të ndërmjetësimit në punësim e shërbime cilësore mjekësore.



---

**MATILDA THOMA** - lindur 1980, Financiere nga themelimi i shoqërisë SiCRED Assistance sh.p.k.; Tiranë, Shqipëri.


Matilda Thoma është diplomuar në Ekonomi në Fakultetin e Ekonomisë, Tiranë, në vitin 2003. Prej vitit 2003 e në vijim ka përfutuar eksperiencë të gjerë në disiplinat financiare dhe fiskale. Që nga themelimi i shoqërisë viti 2012 dhe aktualisht mban pozicionin e Financieres së SiCRED Assistance sh.p.k.. Përpos këtij funksioni znj. Thoma, kryen dhe detyrën e Auditit të Brendshëm të shoqërisë SiCRED sh.a., që prej vitit 2010.



---

**ELONA FETOLLARI TOSKU** - lindur 1988, Juriste pranë shoqërisë SiCRED Assistance sh.p.k.; Tiranë, Shqipëri.

Elona Fetollari Tosku është diplomuar pranë Universitetit "Luarasi", në vitin 2006, me titullin "Jurist". Në vitin 2014 ka përfunduar studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Juridik, duke marrë titullin M.S. në të Drejtën Civile. Prej vitit 2013, është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në Shtator 2014 punësohet pranë SiCRED sh.a., në pozicionin e Juristes, pas një eksperience disa vjeçare në fushën e prokurimeve, përkatësisht që prej vitit 2011. Në Janar 2017, i bashkohet stafit të SiCRED Assistance sh.p.k. në pozicionin e Juristes.



---

**ENEIDA TOSKA** - lindur 1982, Mjeke Pune pranë shoqërisë SiCRED Assistance sh.p.k.; Tiranë, Shqipëri.

Eneida Toska ka mbaruar studimet për Mjekësi të Përgjithshme në vitin 2006. Pas përfundimit të studimeve është punësuar si mjeke e përgjithshme pranë Qendrës Shëndetësore ABC deri në vitin 2008. Përgjatë periudhës 2009 - 2011 ka punuar si mjeke shkolle pranë Tirana International School. Eneida Toska ka kryer specializimin pasuniversitar për Pediatri në periudhën 2011 - 2015. Ajo mban pozicionin e Ekspertes së Vlerësimit të Dëmeve Shëndetësore pranë SiCRED sh.a. prej Majit 2015. Në vitin 2016 znj. Toska i bashkohet SiCRED Assistance sh.p.k., e aktualisht është pjesë e ekipit në pozicionin e mjekes së punës.

## Disa nga partnerët me të cilët kemi punuar

SiCRED Assistance sh.p.k.; pas 6 vitesh eksperience, suksesi që vlerësojmë sot rezulton nga aftësia për të krijuar e transmetuar vlera tek klientët tanë. Klientët tanë përfshijnë drejtues korporatash, borde drejtorësh, shoqëri të huadhënies dhe të investimit me kapital privat, shoqëri shërbimesh, televizione dhe subjekte shëndetësore brenda dhe jashtë vendit me reputacion të lartë. Ne punojmë me disa nga subjektet më të respektuara në vend, por edhe me reputacion të mirë në botë, duke përmendur si më poshtë:



**CREDINS bank**  
*Ne flasim gjuhën tuaj!*



**IDEMIA**  
Aleat



**CCS<sup>®</sup>**  
**Computer & Copier Systems**



**SCAN**



**ISD** INFOSOFT  
SOFTWARE  
DEVELOPER



**SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete



**ASSIBROKER**



**CREDINS**  
INVEST



**HUMANITAS**  
RESEARCH HOSPITAL



**ISTITUTO  
AUXOLOGICO  
ITALIANO**  
Istituto di ricovero e cura a carattere scientifico



**ACIBADEM**  
A CLASS HEALTHCARE SERVICES



**liv**  
**HOSPITAL**



**Këshilluesi juaj ligjor në çështjet e  
legjislacionit të punës, sigurisë e shëndetit,  
ndërmjetësimit në punësim  
e përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm mjekësor**



Me zyra në adresën: Rr. "Brigada e VIII", Vila Nr. 3/I, Tiranë, Shqipëri; NIPT: L21917030K  
Për më shumë informacion konsultoni portalin tonë ose na kërkoni në numrat e mëposhtëm:



Tel: +355 4 22 37 549

Fax: +355 4 22 37 530

[www.sicred-assistance.com.al](http://www.sicred-assistance.com.al)